

## 8.1 BOJRA EPOKSIDE

### EPO PAINT



Njësia matëse	copë/paletë	Konsumi	Ngjyra/specifikime të tjera
1 kg/A&B 5 kg/A&B	12 cp/kuti 45 kova / paletë	0.2-0.3Kg/m <sup>2</sup> --	E Bardhë --



#### EPO PAINT

Produkt dy komponentësh me bazë epokside.

#### PERSHKRIMI

Epo Paint është një produkt dy-komponent, me baze epokside pa praninë e solventeve, duke ofruar fortësi të lartë dhe rezistencë konsumimit. Ky produkt është rezistent ndaj acideve, bazave, produkteve të naf-tës, solventeve, ujë, ujë të detit, etj. Produkti është konfort parametrave të kërkuara nga standardi EN 1504-2.

#### FUSHA E APPLIKIMIT

Epo Paint përdoret si një shtresë mbrojtëse dhe dekorative në sipërfaqe me bazë çimento, p.sh. beton, suva, etj. Produkti është i përshtatshëm për aplikim në zonat industriale, laboratore, fabrikat ushqim të konservuar, fabrika të prodhimit të verës, stacionet e gazit, etj. Ky produkt veçanërisht është i përshtatshëm për aplikim në pishina.

#### MENYRA E PERDORIMIT

##### 1. Siperfaqja

Siperfaqja ku do të aplikohet produkti duhet të jetë:

- E thatë dhe e qëndrueshme.
- Pa praninë e materialeve që pengojnë lidhjen si pluhuri, vajrat, etj..
- Të mbrohet nga lagështia me presion negative.

##### 2. Astarosja

Siperfaqet me baze çimento duhet të trajtohen me astarin EPOXY PRIMER W 4000 ose të trajtohen me EPO PAINT të holluar deri në 20% me ujë.

##### 3. Perzierja

Komponenteve A (rezina) dhe B (fortesuesi) janë të paketuara në dy ambalazhe të veçanta, në raport peshe të paracaktuar. E gjithë sasia e komponentit B shtohet në komponent A. Përzierja e dy komponentëve duhet të bëhet për rreth 5 minuta, duke përdorur një mikser me shpejtesi të ulët, rreth 300 rpm.

##### 4. APLIKIMI - KONSUMI

EPO PAINT duhet të aplikohet brenda 24 orëve pas aplikimit të astarit dhe mbasi astari të jetë tharë. EPO PAINT përdoret siç është ose i hol-

luar deri në masën 5% të peshës me ujë. Aplikohet me rul, furçë apo sferkatje në 2 shtresa. Shtresa e dytë aplikohet pasi shtresa e parë të jetë tharë, por brenda 24 orësh.

#### KONSUMI

400-600 g/m<sup>2</sup>.

#### PAKETIMI

Epo Paint është i ambalazhuar (A+B) në paketim 5 kg, dhe komponentët A dhe B kanë raporte fikse në peshë.

#### JETËGJATËSIA DHE RUAJTJA

24 muaj nga data e prodhimit nëse produkti ruhet në paketim original dhe të pahapur i mbrojtur nga ekspozimi i dretperdrejte në diell si dhe nga ngrica.

#### TË DHËNA TEKNIKE

Baza	Rezinë epokside 2 komponente
Vizkoziteti	5.000 ± 500 mPa.s at +23°C
Densiteti	1,35 kg/lit
Raporti I perzierjes (A:B)	1:3 në peshë
Koha e punueshmërisë	afersisht 60 min në +20°C
Temperatura minimale për fortesim	+8°C
Shkelet	Pas 24 h në +23°C
Shtresa pasuese	pas 24 h në +23°C
Fortësimi final	pas 7 days në +23°C
Rezistenca ndaj konsumimit	< 3000 mg (EN ISO 5470-1)
Forca ngjitëse	≥ 2.5 N/mm <sup>2</sup>